



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Nr. 3504 Prot

Vlorë, më 26 . 12 . 2017

**VENDIM**

Nr. 40 , Datë 20/12 /2017

**PËR MIRATIMIN E VENDIMEVE PËR KALIMIN NË PRONËSI TE PASURIVE TË PALUAJTSHME TË NDËRTUARA DERI ME 10.08.1991, E TË TRUALLIT FUNKSIONAL TË TYRE, KUR NUK POSEDOHEN AKTE FITIMI PRONËSIE DHE PËR REGJISTRIMIN E TYRE.**

Këshilli i Qarkut Vlorë i mbledhur sot më datë 20.12.2017 në zbatim te ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të VKM 608, datë 05.09.2012 “Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.08.1991 e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësi, si dhe për regjistrimin e tyre” i ndryshuar si dhe të vendimeve të dërguara nga Bashkia Delvinë.

**VENDOSI :**

1. Të miratojë Vendimin Nr. 28/1, datë 20.10.2017 “Për kalimin në pronësi të pasurisë së paluajtshme të ndërtuar deri më 10.08.1991 dhe truallit funksional të saj” për subjektin Kërkuar *Znj. Naxhije Veliko (subjekti Znj. Naxhije Veliko me gjeneralitetet sipas certifikatës së datës 10.08.1991*» për një objekt banimi (1 Kat) me sipërfaqe ndërtimi 80.70 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe truall funksional 454 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në lagjen “Sinan Ballaci“, të qytetit të Delvinës, zona kadastrale 1464, nr. pasurie 9/45 që kufizohet nga veriu me pasurinë 9/45 oborr në përdorim, nga jugu me pasurinë 9/45 dhe rrugë, nga lindja me pasurinë 9/45 dhe nga perëndimi kufizohet me pasurinë 9/543.

2. Të miratojë Vendimin Nr. 28/2, datë 20.10.2017 “Për kalimin në pronësi të pasurisë së paluajtshme të ndërtuar deri më 10.08.1991 dhe truallit funksional të saj” për subjektin Kërkuar *Znj. Nafsika Gjino (subjekti Znj. Nafsika Gjino me gjeneralitetet sipas certifikatës së datës 10.08.1991*» për një objekt banimi (2 Kat) me sipërfaqe ndërtimi 53.2 m<sup>2</sup> kati përdhe, 36 m<sup>2</sup> kati i parë dhe sipërfaqe truall funksional 500 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në lagjen “Lejla Malo“, të qytetit të Delvinës, zona kadastrale 1464, nr. 1/23 që kufizohet nga veriu me



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I QARKUT VLORË

pasurinë 1/23, nga jugu me pasuritë 1/50 dhe 19/38, nga lindja me pasurinë 1/23 dhe nga perëndimi kufizohet me pasurinë 1/23, pjesa e tokës përreth është në posedim të këtij subjekti i cili lidhet me rrugën nga pjesa veri – perëndimore.

KRYETARI

  
Eryis MOÇKA

*Shpallur nga Prefekti i Qarkut Vlorë me Nr. 17 Prot, datë 04.01.2018*

Adresa: Këshilli I Qarkut Vlorë  
Sheshi "4 Heronjtë", Vlorë  
Vlorë (AL)

Web site : [www.qarkuvlore.gov.al](http://www.qarkuvlore.gov.al)  
E-mail: [info@qarkuvlore.gov.al](mailto:info@qarkuvlore.gov.al)  
Tel: +355 33 421 608